



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:202366  
Datë: 17.05.2024  
Numri i dokumentit: 05701228

**C.nr.1924/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.K., me seli në Prishtinë, e përfaqësuar sipas autorizimit nga K.Sh., kundër të paditurit G.H. nga Peja, i përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm Sh.Z., avokat nga Prishtina, me objekt kontesti: kompensim dëmi, në seancën e shqyrtimit kryesor publik në prani të autorizuarit të paditëses dhe të përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, ndërsa me datë 17.05.2024, e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET në tërësi e pa bazuar** kërkesëpadia e paditëses D.K. me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri G.H., që paditëses D.K. t'ia kompensoj dëmin që i është shkaktuar si pasojë e mos pagimit të detyrimeve doganore në vlerë prej 7,779.00 euro, me kamatë ligjore 8% nga data e paraqitjes së padisë si dhe shpenzimet e procedurës, në afat prej 15 ditëve nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

**II.** Secila palë i bartë për vete shpenzimet e procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësja në padinë e parashtruar me datë 20.05.2011, dhe në seancat e mbajtura gjyqësore ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet i padituri G.H., që paditëses D.K. t'ia kompensoj dëmin që i është shkaktuar si pasojë e mos pagimit të detyrimeve doganore në vlerë prej 7,779.00 euro. Paditësja pretendon se i padituri me rastin e importimit të mallit nuk ka deklaruar saktë vlerën e mallit kur ka hyrë në pikën doganore të Hanit të Elezit, dhe i njëjti ka deklaruar vlerën, gjegjësisht taksën doganore prej 9,315 euro, duke paraqitur edhe faturë fiktive prej 13,703 euro, ndërsa vlera e mallit sipas dokumentacionit që është përcjellë nga shteti i Maqedonisë është 26,798.40 euro. Paditësja pas aktgjykimit të Gjykatës të Qarkut në Prishtinë Ap.nr.294/09, për realizimin e kërkesës pasurore është udhëzuar në kontest civil. Ka deklaruar se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale shmangie mashtruese nga neni 92 paragrafi 1 i Kodit Doganor të Kosovës me Aktgjykimin P.nr.211/05 të datës 19.03.2009 të Gjykatës në Kaçanik, si Gjykatë e shkallës së parë penale sepse i njëjti me rastin e importimit të mallit kafe e pjekur të llojit "R.M.", në D.K. ka paraqitur vlerë me të ulët për mallin në fjalë, me qëllim të shmangieve të taksave doganore, dhe është obliguar nga gjykata që D.K. t'ia kompensoj shumën prej 7,779.00 euro. Në fjalën përfundimtare e autorizuara e paditëses i propozon gjykatës që padia dhe kërkesëpadia të

aprovohet si e bazuar duke e detyruar të paditurin që doganës t'ia kompensoj dëmin e theksuar si në petitumin e kërkesëpadisë dhe me kamatë ligjore 8% nga data e paraqitjes së padisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, por pa i specifikuar.

Me aktvendimin e datës 22.04.2022, sipas propozimit të paditëses gjykata i ka caktuar të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm Sh.Z. avokat nga Prishtina, për të vepruar në emër të tij, dhe ketë bazuar në nenin 79 paragraf 3 pika a) të LPK-së, për faktin se nuk është arritur të sigurohet adresa e vendbanimit.

Përmes përgjigjes në padi dhe në seancat e mbajtura gjyqësore, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, për faktin se me aktgjykimet e gjykatave të Kosovës nuk është vërtetuar në mënyrë meritore se a i ka shkaktuar dëm paditëses këtu D.K., dhe meqenëse kemi aktgjykime ku nuk është provuar fajësia e të paditurit dhe duke parë provat me të cilat është mbështetur padia konsiderojmë se nuk ka prova që dëshmojnë se i padituri të këtë shkaktuar dëm paditëses. Gjithashtu, sa i përket borxhit të pretenduar nga ana e paditëses i njëjti borxh edhe nëse ekziston ose nëse ka ekzistuar është përfshirë në faljen e borxheve sipas Ligjit nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve ku është paraparë falja e borxheve deri me datë 31.12.2008, e meqenëse ky borxh pretendohet të jetë i vitit 2004 ne pretendojmë se i njëjti është përfshirë në falje të borxheve. Tutje ka shtuar se, sa i përket vendimeve të gjykatës në procedurë penale në atë çështje nuk kemi vendim meritore sepse i njëjti është vendosur lidhur me parashkrim absolut dhe nuk ka vërtetuar gjendjen faktike se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses apo jo. Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i përkohshëm i propozon gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përgjigje në padi 104.00 euro, për parashtresën e datës 13.09.2022 shumë prej 104.00 euro, për 4 seanca gjithsej shumë prej 540.80 ku për një seance shumë prej 135.20, në total shumë prej 748.80 euro.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse, gjykata ka administruar provat si në vijim: të dhënat nga ARBK lidhur me të dhënat e biznesit, deklarata e lëshuar nga "E.Sh." e datës 21.02.2005 së bashku me deklaratën e transitit, dokumentet unike doganore të datës 31.08.2004, memorandum i datës 09.12.2004, përgjigja nga Republika e Maqedonisë e datës 25.11.2004, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kaçanik P.nr.211/05 i datës 19.03.2009, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AP.nr.294/09 i datës 12.01.2011, pro fatura nr.04362 e lëshuar nga C.CL në Republikën e Maqedonisë, pro fatura me nr. ref. 2414-15 e datës 18.06.2004, ekspertiza financiare e datës 31.07.2023, si dhe CMR nga SGS I.SRI.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e refuzoj në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje juridike kontestimore, si çështje kontestuese paraqitet baza e kërkesëpadisë, lidhur me atë nëse i padituri ka prezantuar para D.K.

fatura fiktive me qëllim të shmangies së obligimeve doganore, me çka paditësja pretendon se i është shkaktuar dëm material në lartësi prej 7,779.00 euro.

Nga të dhënat e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, përkatësisht formularit të regjistrimit, gjykata konstatoj se i padituri është pronar i biznesit individual N.P.T. S. me seli në Fushë Kosovë, i njëjti biznes është regjistruar me datë 14.05.2004, ndërsa nga data 09.06.2022 statusi i tij në ARBK është pasiv.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kaçanik P.nr.211/05 i datës 19.03.2009, gjykata vërtetohet faktin se i padituri është shpallur fajtor nga kjo gjykatë, sepse më datën 31.08.2004 në degën doganore Hani i Elezit, firma “S.” nga Fushë Kosova menaxher i se cilës është i akuzuari, këtu i padituri, është përfshirë në shmangien mashtruese nga pagesa e detyrimit të doganës ashtu që ka paraqitur dokumentin për zhdoganim të mallit - 400 thasë kafe e pa pjekur “R.M.” me DUD të datës 31.08.2004 në vlerë prej 13.703,00 € edhe pse për të njëjtën sasi të mallit në Doganën e Maqedonisë ka paraqitur vlerën prej 25.802,4 € dhe me këtë ka shkaktuar evazion ndaj buxhetit të konsoliduar të Kosovës për mjete të paguara më pak në emër të përqindjes së doganës dhe TVSH-së në lartësi prej 7.799,00€, sipas të cilit aktgjykim këtu i padituri ka kryer veprën penale “*Shmangie mashtruese nga pagesa e detyrimeve nga neni 92 paragraf 1 pika a e Kodit Doganor të Kosovës*”.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AP.nr.294/09 i datës 12.01.2011, gjykata konstatoj se është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kaçanik P.nr.211/05 i datës 19.03.2009 dhe është refuzuar propozim akuza, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, ndërsa i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Përmes shkresës së titulluar si memorandum i datës 09.12.2004, gjykata konstatoj se paditësja i është drejtuar Administratës Doganore të Maqedonisë, lidhur me paraqitjen e dokumenteve të transitit nga ana e firmës “S.” me seli në Fushë Kosovë, e cila ka importuar kafe të pa pjekur të deklaruar me datë 01/09/04 dhe me numër DUD-1 T-8558. Sipas këtij komunikimi, paditësja pretendon se ky importues, në këtë rast i padituri, ka ndërruar dokumentet e dërgesës siç edhe është dokumentuar me rastin e marrjes së përgjigjes nga shteti i Maqedonisë. Po ashtu, në këtë shkresë theksohet se dokumentet e marra nga shteti i Maqedonisë tregojnë se e njëjta dërgesë ka kaluar transit nëpërmjet Maqedonisë, me emër tjetër të importuesit Kosovar, me emër N.P.T. B. - Gjakovë.

Nga përgjigja e Republikës së Maqedonisë e datës 25.11.2004, gjykata konstatoj se Administrata Doganore nga Republika e Maqedonisë i është drejtuar Doganës së UNMIK-ut, duke i dorëzuar kopjen e transit dokumentit D28443/CI 4010 Bogorodica të datës 31.08.2004, dalja e mallrave që kalonin transit nga pika kufitare Bogorodica për pikën kufitare në Bllacë, është konfirmuar me numrin e kontrollit 36339/CI Blacë e datës 31.08.2004.

Nga kallëzimi penal i paraqitur nga D.K. drejtuar Prokurorisë Komunale në Ferizaj kundër të paditurit, si konkludim i këtij kallëzimi penal, sipas paditëses rezulton se në bazë të raportit të sektorit të inteligjencës dhe në bazë të dokumenteve me të cilat posedon paditësja pronari i firmës

“S.” nga Fushë Kosova, pranë D. D. Hani i Elezit ka deklaruar dokumente fiktive për mallin kafe e pajjekur “R.M.”. Me këtë rast, pronari i firmës “S.” G.H. dyshohet se ka kryer veprë penale të sanksionuar në bazë Seksionit 91 të Kodit Doganor, duke prezantuar pranë Shërbimit Doganor të UNMIK-ut dokumente të pavërteta, pra duke mos e deklaruar saktë vlerën e mallit me qëllim të shmangies ndaj pagesës së obligimeve doganore dhe TVSh-së. Diferenca në mes të faturës fiktive dhe asaj reale është 12099.40 € gjë që është reflektuar me evazion ndaj Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për mjetet të paguara më pak në emër të përqindjes së doganës dhe TVSH- së në lartësi prej 7799 €.

Nga ekspertiza e hartuar me datë 31.07.2023 nga ekspertja financiare G.Sh., gjykata konstatoj se e njëjta ka arritur në përfundim se i padituri në emër të deklarimeve të bëra në D.K.sipas DUD-it doganor R-8558/31.08.2004 me datë 31.08.2004 dhe deklarimeve në Doganën e Maqedonisë, për mallin e blerë të llojit kafe e pa pajjekur “R.M.” është i obliguar t’i kompensoj paditëses vlerën shtesë në emër të taksave doganore dhe tatimit në shumën totale prej 7,779.00 euro. Nga analizimi i kësaj ekspertize, gjykata konstatoj se në këtë përfundim ekspertja ka arritur mbi bazën e kalkulimit të vlerës së mallit të deklaruar në D.K. dhe vlerën e mallit të deklaruar në Doganën e Maqedonisë, në të cilën ekspertja ka theksuar se në shkresë të lëndës nuk gjendet ndonjë faturë tjetër origjinale, DUD tjetër, pagesë apo ngjashëm, përmes të cilave do të ishte më i lehtë vlerësimi i vlerës për të cilën ndërlihet kontesti përkatës. Ekspertja ka shtuar se, në mungesë të provave tjera në dosje të lëndës përkatëse, rezulton se diferenca në mes të Deklaratës në Doganën e Maqedonisë dhe DUD-it të paraqitur në D.K. është 12,345.06 euro, ndërsa në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të Kodit Doganor dhe dispozitave të tjera në fuqi që ndërlihen me nivelin e përqindjes doganore dhe tatimit mbi vlerën e shtuar arrin shumën prej 7,779.00 euro.

Bazuar në deklaratimet e palëve ndërgjyqese dhe provat e administruara si më lartë, gjykata konstatoj se ndaj të paditurit është iniciuar procedurë penale, me pretendimin se i njëjti ka paraqitur fatura fiktive pranë të paditëses me qëllim të përfitimit pasuror, ndërsa propozim akuza ndaj tij është refuzuar për faktin se vepra penale është parashkruar. Rrjedhimisht, në procedurë penale nuk është konstatuar fakti se nëse faturat e prezantuara nga i padituri janë fiktive.

Meqenëse, në rastin konkret pretendim i paditëses është kompensimi i dëmit i shkaktuar në vitin 2004, gjykata vlerëson se në këtë çështje juridike civile duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (GZ e ish-RSFJ, nr. 30, datë 30.03.1978), i cili në nenin 154 paragraf 1 parasheh se: “*Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”. Ndërsa me nenin 158 të të njëjtit ligj parashihet se: “*Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia*”.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit duhet të plotësohen disa kushte, dhe atë: të shkaktohet dëmi, të ekzistojë veprimi i kundërligjshëm, të ekzistojë lidhja kauzale mes shkakut dhe pasojës, si dhe të ekzistojë fajësia. Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës gjykata nuk ka gjetur prova për të argumentuar përgjegjësinë e të paditurit, i cili me veprimet e veta të kundërligjshme ka shkaktuar pasojën apo dëmin të cilin e pretendon paditësja, kjo për faktin se gjykata në këtë procedurë e kishte të pamundur të arrij në ndonjë konstatim në raport me faturat e paraqitura në cilësi të provave.

Andaj, bazuar në këtë rrethanë, gjykata vlerëson se pa ekzistimin e një prove vendimtare lidhur me përgjegjësin e të paditurit, e cila do të konstatonte faktin vendimtar lidhur me atë se nëse faturat e prezantuara janë fiktive apo jo, nuk mund të vërtetohet kundërligjshmëria si element i përgjegjësisë për dëmin. Rrjedhimisht, mungon lidhja kauzale në mes të veprimit dëmtues dhe pasojës.

Gjykata konstaton se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kaçanik P.nr.211/05 i datës 19.03.2009, në të cilin paditësja thirret si provë, është anuluar nga Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AP.nr.294/09 i datës 12.01.2011, dhe është refuzuar propozim akuza, dhe i njëjti në aspektin juridik nuk prodhon asnjë efekt juridik dhe gjykata në procedurën kontestimore nuk është e lidhur me të dhe as me gjendjen faktike të vërtetuar nga ky aktgjykim. Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”* mirëpo, në këtë rast aktgjykimi i prezantuar si provë, është anuluar dhe nuk i plotëson kushtet të cilat kërkohen me nenin 14 të LPK-së.

Gjykata i vlerësoj provat e prezantuara nga pala paditëse përkatësisht deklaratën e lëshuar nga “E.Sh.” e datës 21.02.2005 së bashku me deklaratën e transitit, dokumentet unike doganore të datës 31.08.2004, pro faturën nr.04362 e lëshuar nga C. CL në Republikën e Maqedonisë, pro fatura me nr.ref.2414-15 e datës 18.06.2004, si dhe shkresat CMR nga SGS I. SRI, mirëpo e kishte të pamundur të arrij në përfundim nëse i padituri ka bërë ndryshime të faturave, në shtetin e Maqedonisë dhe rrjedhimisht këtë ndryshim të faturave e ka paraqitur përmes faturave fiktive në Doganën e Kosovës, e po ashtu të konstatoj se nëse e njëjta dërgesë ka kaluar transit nëpërmjet Maqedonisë, me emër tjetër të importuesit Kosovar, me emër N.P.T. B. - Gjakovë.

Njëkohësisht, gjykata e analizoj dhe vlerësoj edhe ekspertizën financiare, mirëpo e njëjta nuk kishte ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në raport me bazën juridike të kërkesëpadsisë. Kjo për faktin se, përmes kësaj ekspertize vetëm është bërë llogaritja e të dhënave të prezantuara përmes faturave nga pala paditëse, pa u lëshuar në atë nëse faturat janë fiktive, sepse një çështje e tillë sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk hynë në kompetencë të ekspertit. Për më shumë, edhe në aspektin e përlllogaritjes së shumave, kjo ekspertizë nuk e arrin nivelin e besueshmërisë për gjykatën, sepse sipas ekspertes, me rastin e hartimit të saj, e njëjta ka theksuar se në shkresa të lëndës nuk gjendet ndonjë faturë tjetër origjinale, DUD tjetër, pagesë apo ngjashëm, përmes të cilave do të ishte më i lehtë vlerësimi i vlerës për të cilën ndërlidhet kontesti përkatës, e në mungesë të provave tjera në dosje të lëndës, ekspertja ka arritur në përfundim se diferenca në mes të Deklaratës në Doganën e Maqedonisë dhe DUD-it të paraqitur në D.K. është 12,345.06 euro.

Në lidhshmëri me të lartcekurat, e duke marr për bazë faktin se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, e në përputhje me nenin 7 paragraf 1 të LPK-së, i cili përcakton rolin aktiv të të dyja palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor, sipas të cilit: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, e po ashtu, në përputhje me

paragrafin 1 të nenit 319 të LPK-së, sipas të cilit: “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.*”, gjykata vendosi sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në raport me shpenzimet, gjykata vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale, ashtu siç përcaktohet me nenin 450 të LPK-së.

Bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e neneve 142 dhe 143 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.1924/2018, me datën 17.05.2024**

**Gjyqtari**  
Argzon Muçaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.